



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e zhvillimit të arsimit
Ministry of Education and Science - Bureau for Development of Education

Udhëzim për realizimin e mësimit

**NË SHKOLLAT FILLORE TË VEÇANTA,
NË PARALELET E VEÇANTA NË SHKOLLAT
FILLORE DHE NË SHKOLLAT E MESME
SHTETËRORE PËR NXËNËSIT ME NEVOJA TË
VEÇANTA ARSIMORE NË VITIN SHKOLLOR
2020/2021**



Mësimi në shkollat fillore të veçanta, në paralele të veçanta në shkollat fillore dhe në shkollat e mesme shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA) ose më konkretisht për nxënësit me aftësi të kufizuara që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale ose shqisore afatgjate¹, realizohet sipas planeve dhe programeve mësimore të përshtatura me mundësitë dhe aftësitë e nxënësve me pengesa të ndryshme (dëmtimi i dëgjimit, dëmtimi i shikimi, pengesa e zhvillimit mendor/aftësia e kufizuar e zhvillimit mendor/ pengesa në zhvillimin mendor/ pengesa në zhvillimin intelektual, autizmi dhe multihendikepi/ me shumë lloje të pengesave, aftësisë së kufizuar / pengesa të ndryshme).²

Programet mësimore janë përshtatur (reduktuar) në numrin e lëndëve dhe numrin e orëve me të cilat ato përfaqësohen në nivel javor, përkatësisht në nivel vjetor.

Programet mësimore janë përshtatur në të gjitha segmentet e strukturës së programit, përfshirë shtrirjen dhe intensitetin e zbatimit të tyre.

Përpilimi i Planit arsimor individual (PAI) ose programit të modifikuar mundëson përshtatje shtesë të mësimdhënies me aftësitë dhe mundësitë psiko-fizike të secilit nxënës me aftësi të kufizuara, përfshirë planifikimin e kornizës kohore të realizimit.

Programet mësimore të përshtatura, fleksibiliteti i zbatimit të tyre dhe mundësia e përgatitjes së një plani arsimor individual (PAI) ose programit të modifikuar për secilin nxënës, i lejon mësimdhënësit të planifikojë mësimin për 159 ose 145 ditë mësimore, në përputhje me Vendimin e Qeverisë së RMV, që viti shkollor 2020/2021 të fillojë më 1 tetor 2020, për shkak të situatës së krijuar me pandeminë Kovid-19.

Mësimi në këto shkolla do të realizohet në përputhje me propozimin e Komisionit të formuar nga Qeveria për shqyrtimin e kërkesave

1) <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/dc070a58a138483aa68da4517a10ac1e.pdf>
Ligji për arsim fillor

2) https://www.bro.gov.mk/%D0%BF%D0%BE%D0%B4%D0%BA%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%B8/?idcat=180&custompost-type=documents_category
Programet mësimore të përshtatura për arsimin fillor nëntëvjeçar për nxënësit me dëmtim të dëgjimit, shikimit, pengesa në zhvillimin psikik, autizëm dhe multihendikepi.
<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/fb7e5c35ab144f3eb7d9840f876ca818.pdf>
Rregullore për vlerësimin e shikimit dhe shkallën e pengesës të personave në zhvillimin mendor dhe fizik



të paraqitura për organizimin e orëve me prani fizike, nga rekomandimet e Komisionit për sëmundjet infektive dhe nga vendimi i Qeverisë për dhënien e pëlqimit për organizimin e mësimit me prezencë fizike.

1 Realizimi i mësimit në shkollat fillore të veçanta ose në paralelete veçanta në shkollat fillore

Në kushtet e pandemisë me Kovid-19, shkollat fillore të veçanta që planifikojnë procesin edukativo-arsimor për vitin shkollor 2020/2021 duhet:

- ▶ të sigurojë kushte për realizim të pandërprerë dhe të sigurt të mësimdhënies (mjedis i sigurt shkollor përmes stafit të përgatitur për mirëmbajtjen e higjienës dhe dezinfektimit, organizimin e lëvizjes së nxënësve, riorganizimin e mobiljeve në klasë për të arritur distancën e kërkuar të sigurt ndërmjet nxënësve prej 1.5 metra, mbikëqyrje të organizuar nga mësimdhënësit dhe personeli tjetër i shkollës në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Komisioni për sëmundjet infektive);
- ▶ të sigurojë fleksibilitet në planifikimin e mësimdhënies që shpie në praktika mësimore që do të sigurojnë arritje të përshtatshme për aftësitë individuale të nxënësve (sipas PAI ose programit të modifikuar të nxënësit);
- ▶ për të ndërtuar një klimë, strukturë dhe organizim shkollor ku kujdesi, respekti dhe mbështetja holistike kanë një vend qendror në misionin e shkollave;

Mësimi në shkollat fillore të veçanta ose paralelet e veçanta pranë shkollave fillore do të realizohet në mënyrë të kombinuar:

- ▶ me prani fizike në klasa ose oborre të destinuara për nevojat dhe mundësitë e nxënësve, të cilat do të pajisen në mënyrë adekuate me mjete materiale-teknike dhe mjete ndihmëse mësimore në lëndë të caktuara dhe
- ▶ mësimdhënia e drejtpërdrejtë në internet, përmes mësimit elektronik në distancë, i destinuar kryesisht për nxënës me kushte kronike ose sëmundje tjera shtesë (komorbilitete), si dhe për nxënës të tjerë me nevoja të veçanta arsimore për të cilët prindërit do të deklarohen për këtë lloj mësimi.



Numri i vogël i nxënësve në klasa dhe kushtet materialo-teknike dhe hapësinore me të cilat disponojnë shkollat fillore të veçanta plotësojnë kriteret e përshkruara në protokollet për mbrojtje në situatën e re të krijuar me Covid-19 dhe zbatimin e pandërprerë të procesit edukativo- arsimor me praninë fizike të nxënësve në klasë.

Mësimi me prani fizike në shkollat fillore të veçanta do të organizohet dhe realizohet pesë ditë pune në javë, gjatë së cilës do të përgatitet një orar i veçantë me një numër të caktuar ditësh dhe orësh mësimore, varësisht të aftësive psiko-fizike dhe shëndetësore të nxënësve.

Orët e arsimit fizik dhe shëndetësor, orët e arsimit muzikor mund të realizohen në oborrin e shkollës, si dhe orët e njohjes së mjedisit, nëse njësia mësimore e lejon atë, duke respektuar të gjitha rekomandimet dhe masat për mbrojtjen dhe parandalimin e Covid-19.

Kohëzgjatja e orës që do të realizohet në klasë ose në oborrin e shkollës, me praninë fizike të nxënësve dhe mësimdhënësve, i përket një kornize kohore fleksibile deri në 30 minuta, ku rekomandohet vetëm një pushim ndërmjet orëve në kohëzgjatje 20 minuta, dhe pushime të tjera ndërmjet orëve që zgjasin 5 minuta, realizohen në klasë, përveç nëse nxënësi ka nevojë të shkojë në tualet ose ndonjë lloj tjetër i nevojës urgjente.

Planifikimi i mësimin duhet të jetë në përputhje me planin mësimor, programet mësimore, planin individual arsimor ose programin mësimor të modifikuar.

Planifikimi i orës mësimore me kohëzgjatje prej 30 minuta duhet t'i përfshijë këto elemente:

- ▶ qëllimet konkrete dhe rezultatet e pritura për çdo orë;
- ▶ përmbajtjet e programit nga fusha/tema e lëndës përmes së cilës do të realizohen qëllimet edukative-arsimore;
- ▶ aktivitetet, format organizative dhe metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies (ku duhet të mbizotërojnë metodat aktive të mësimnxënies);
- ▶ koha për realizimin e pjesëve të orës (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe pjesa përfundimtare e orës) në raport me qëllimet e programit dhe rezultatet e pritura;
- ▶ mjetet dhe materialet didaktike që do të përdoren, si dhe
- ▶ metodat, teknikat dhe instrumentet për ndjekjen dhe vlerësimin e të arriturave të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Në formësimin didaktiko-metodik të orës, duhet të respektohen rekomandimet didaktike nga programet mësimore, të cilat parashikojnë mjete didaktike, materiale, metoda, teknika, instrumente për nxënësit, të përshtatshme për shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar.



Nxënësit me aftësi të kufizuara në shikim, aftësitë intelektuale të cilëve janë në një gjendje më të mirë mund të ndjekin normalisht pa ndërprerje orët me prani fizike në klasa ose oborre të dedikuara **për nevojat dhe mundësitë e këtyre** nxënësve, dhe mësimdhënie online, përmes mësimin elektronik në distancë, nëse prindërit deklarohen, bien dakord për këtë lloj mësimi.

Mësimdhënësit përdorin mjete mësimore specifike dhe mjete ndihmëse të dedikuara për personat me dëmtime të shikimit, të tilla si aplikimi i një thjerrë për të zmadhuar shikimin e përmbajtjes, ose përmbajtje të parapërgatitur me font të rritur dhe më të trashë për nxënësit me shikim të dobët, dhe për nxënësit e verbër janë përgatitur njësi mësimore me alfabetin e Brajovit, aplikimi i mjeteve audio-vizuale dhe prekëse, interneti, aplikimi i softuerit arsimor në kombinim me programin e të folurit me tinguj; mjete mësimore lehtësuese / taktile, prekëse, etj. Për nxënësit të cilët, përveç shikimit të dëmtuar, kanë aftësi të kufizuara të tjera dhe nuk janë në gjendje të zotërojnë materialin mësimor, atëherë mësimdhënësi duhet të zbatojë një qasje individuale dhe të diferencuar, si dhe përgatitjen e një plani individual arsimor, nëse nxënësi nuk është në gjendje të arrijë qëllimet e programit mësimor dhe rezultatet e mësimnxënies.

Modeli i kombinuar i mësimdhënies me prani fizike dhe mësimdhënie përmes mësimin elektronik në distancë, mund të ndiqet nga nxënësit me dëgjim të dëmtuar, ku mësimdhënësi ka liri në vlerësim, përzgjedhje dhe zbatim të metodave të përshtatshme të mësimdhënies, në varësi të llojit të orës, përmbajtjes mësimore të parashikuar për atë orë, karakteristikat individuale të nxënësve (njohuritë e tyre paraprake, sukcesi, shprehitë e punës, etj.), pajisjet dhe disponueshmëria e mjeteve mësimore, teknologjia e mësimdhënies, etj.

Ora mësimore realizohet duke aplikuar një ose më shpesh me një kombinim të disa metodave të mësimdhënies, dhe në varësi të aftësive individuale dhe peshës së materialit mësimor në punë, mund të përdoret metoda e daktilologjisë si dhe gjuha e shenjave, pajisjet surdoteknike (individuale dhe grupore) aparate dëgjimi, mikrofon, kufje, etj.).

Gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara intelektuale, aftësi të kufizuara të kombinuara/aftësi të kufizuara dhe autizmi, theksi më i madh duhet t'i kushtohet qasjes individuale të mësimdhënies. Përdorimi i kompjuterëve dhe internetit, si dhe mjetet mësimore vizuale dhe dëgjimore, kanë një rëndësi të veçantë. Për këta nxënës është e nevojshme të zbatohet material didaktik që është interesant, i ndryshëm dhe nuk është i ngarkuar me detaje të panevojshme.

Për nxënësit me aftësi të kufizuara intelektuale që zakonisht mësojnë përmes imitimit, dhe për të cilët mësimdhënësi zakonisht është në rolin e një modeli identifikimi, mësimi me prani fizike ka një rëndësi të veçantë.

Gjatë planifikimit, mësimdhënësi duhet të respektojë parimin e të mësuarit funksional, përkatësisht ajo që është mësuar në orë duhet të jetë praktikisht e zbatueshme në jetën e përditshme, e cila është një motiv shtesë për nxënësit për të mësuar më shpejt dhe më me sukses. Nxënësit do të motivohen dhe interesi për të mësuar do të jetë më i madh nëse përmbajtja mësimore paraqitet në formën e një tregimi, me një stil të afërt



dhe të kuptueshëm për nxënësit. Duhet të shmangët ngarkesa me të dhëna faktografike e cila është pothuajse e papërdorshme për këta nxënës.

Për nxënësit me aftësi të kufizuara të kombinuara/mësimdhënia me shumë aftësi të kufizuara (multihendikep) me prani fizike është e një rëndësie të veçantë për përvetësimin dhe zgjerimin e përvojave të tyre specifike dhe paranjohurive dhe njohurive. Përdorimi i mjeteve mësimore më të përshtatshme është i nevojshëm në shpjegimin e koncepteve të reja për përafrimin e suksesshëm të konceptit të ri të nxënësi. Mësimdhënësi duhet të përdorë gjësende konkrete dhe/ose modelet e tyre, fotografi të zgjedhura me kujdes, vizatime, ilustrime, filma dhe të ngjashme.

Për shkak të vështirësive për të kuptuar shumë shprehje, fakte, abstraksione dhe përgjithësime si dhe aftësive të dobëta të të folurit, është e vështirë për nxënësit të arrijnë pavarësinë në shprehjen e përmbajtjes së ristrukturuar, për shkak të së cilës komunikimi i drejtpërdrejtë me mësimdhënësin është i domosdoshëm në realizimin e mësimdhënies.

Gjatë realizimit të procesit edukativo-arsimor me nxënës me aftësi të kufizuara të kombinuara / aftësi të kufizuara që kanë dëgjim të dëmtuar, duhet punuar me material të pasur me ilustrime. Një fotografi, vizatim, ilustrim i zgjedhur mirë mund t'i sigurojë nxënësit atë që ai/ajo dëshiron ta kuptojë intelektualisht, ta përpunojë atë logjikisht dhe në të njëjtën kohë të dëshirojë të shprehet duke përdorur fjalimin.

Te nxënësit me aftësi të kufizuara të kombinuara/aftësi të kufizuara (multihendikep) **që kanë shikim të dëmtuar ka ndryshime dhe variacione që lidhen kryesisht me shpejtësinë dhe ritmin e zhvillimit të tyre, si dhe një ritëm më të ngadaltë të marrjes së aftësive dhe njohurive të caktuara, të cilat duhet të merren parasysh realizimi i mësimin me prani fizike ose gjatë mësimin në distancë.**

Për përfshirjen e suksesshme të nxënësve me autizëm në procesin edukativo-arsimor është e nevojshme të sigurohet një ndjenjë sigurie, një ndjenjë besimi të mësimdhënësi, duke siguruar një skemë të caktuar në aktivitetet e përditshme, parashikueshmërinë kohore dhe hapësinore dhe informacionin në lidhje me aktivitetet e planifikuara ditore. Mësimi i pranisë fizike është i një rëndësie të veçantë për plotësimin e nevojës për komunikim aktiv që kanë këta nxënës, si dhe një mundësi e shkëlqyeshme për të siguruar informacion të duhur dhe të thjeshtë verbal, akustik dhe vizual. Këta nxënës **përparojnë në një mjedis pedagogjik të strukturuar mirë, ku theksi në planifikim duhet të vihet në zhvillimin optimal të aftësive në fushën e pjesëmarrjes shoqërore dhe ndërveprimit.** Karakteristikë e nxënësve me autizëm është mospranimi dhe reagimi i papërshtatshëm ndaj disa metodave standarde të mësimnxënies dhe mësimdhënies.

Për këta nxënës është e nevojshme të përgatitet një plan arsimor individual me qëllime të përcaktuara qartë, i modifikuar varësisht të nevojave dhe aftësive të nxënësit.



Duke respektuar qasjen gjithëpërfshirëse (holistike) në punën me nxënësit në mësimin klasor dhe lëndor, është e nevojshme të integrohen në planifikimin e mësimdhënies dhe realizimin e orëve.

Gjatë realizimit të orës mësimore në të cilën zhvillohet përmbajtje e re mësimore, ora duhet të përbëhet nga një pjesë hyrëse, aktivitetet e mësimdhënies së nxënësve për mësimin klasor ose pjesa kryesore për mësiminlëndor dhe pjesa përfundimtare. Për realizimin e orëve të planifikuara të mësimdhënies klasore dhe lëndore, rekomandohet fleksibiliteti në organizimin e mësimit.

Detyrat e shtëpisë nuk duhet të jenë të detyrueshme për çdo orë. Detyrat e shtëpisë si dhe vetë mësimi duhet të kenë një qëllim specifik, përkatësisht ato duhet ta drejtojnë nxënësin në rezultatin e të nxënësit për atë përmbajtje. Detyrat e shtëpisë / detyrat e shtëpisë individuale të dhëna nga mësimdhënësi duhet të jenë të përshtatshme me moshën e nxënësve dhe llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar.

Gjatë realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi nevojitet t'i shënojë arritjet e nxënësve, mbledhjen e rregullt dhe të menduar të të dhënave përkatëse për përparimin e tij/saj, arritjen e rezultateve në mësimnxënie dhe nivelin e arritur të zhvillimit të kompetencave të përgjithshme dhe specifike të nxënësit.

Informimet me gojë dhe/ose me shkrim për nxënësit janë të detyrueshme për secilën orë dhe mësimdhënësi ua drejton atë në një formë pohuese nxënësve në mënyrë që të inkurajojë dhe mbështesë procesin e të nxënësit.

Mësimdhënësi përdor, gjithashtu një sistem për shënimin apo regjistrimin e pranisë së nxënësve në mësim.

Për prindërit /tutorët e fëmijëve me sëmundje të frymëmarrjes, kronike dhe/ose të rralla, si dhe nxënës të tjerë me nevoja të veçanta arsimore që vendosin të ndjekin mësimin në distancë, nga shtëpia, mësimdhënësit do të përgatisin përmbajtje mësimore, materiale mësimore, prezantime, të publikuara në ueb faqen e shkollës, si dhe përdorimi i mjeteve arsimore të propozuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja e zhvillimit të arsimit, duke marrë parasysh nevojat/llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar të nxënësit.

Për nxënësit që do të ndjekin mësimet nga shtëpia dhe kanë nevojë për mbështetje profesionale, mësimdhënësi përgjegjës do të sigurojë shërbime këshillimi dhe këshillime përkatëse për prindërit, prezantime të ushtrimeve dhe aktiviteteve dhe udhëzime për menaxhimin e nevojave individuale në kushte shtëpie. Kjo mbështetje do të realizohet përmes platformës/platformave që do të miratohen në nivelin e shkollës.

Mësimi në distancë do të realizohet me një kombinim të disa platformave arsimore dhe aplikacioneve dixhitale. Platforma nacionale, portali Eduino, Google classroom, duke krijuar një platformë Google Drive dhe duke përdorur mjete të tjera alternative të komunikimit elektronik (viber, messenger, zoom). Materialet edukative (prezantime, libra shkollorë, lidhje të dobishme në lidhje



me përmbajtjen e mësimdhënies, aplikacione, lidhje nga platforma nacionale) do të ndahen me nxënësit në periudhë kohore dhe në bazë të planeve speciale të përgatitura nga secila shkollë dhe të aprovuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për shkak të specifikave të nevojave të nxënësve, secila shkollë do të përpilojë edhe përmbajtje plotësuese edukative-zhvillimore.

Gjatë realizimit të mësimin në distancë, mësimdhënësi komunikon me nxënësit përmes platformës nacionale, gjithashtu mësimdhënësi për orë të caktuara mund të dërgojë një lidhje tek nxënësit nga video përmbajtja nga baza e të dhënave të EDUINO para realizimit të orës, në mënyrë që ata të përgatiten dhe më lehtë për të realizuar orën. Mësimdhënësi, gjithashtu mund të përdorë platformën në shkollën e tij për të vendosur materiale mësimore, ose për të rekomanduar përdorimin e materialeve mësimore nga platforma të tjera që mundësojnë realizimin e qëllimeve të orës së mësimin dhe arritjen e rezultateve tëparashtruara të mësimnxënies.

Aktivitetet do të sigurohen në përputhje me të gjitha aspektet e zhvillimit të personalitetit të nxënësve dhe mund të përdoren si mbështetje plotësuese për organizimin e kohës së lirë.

Aktivitetet, përveç faqes në internet të shkollës, mund të publikohen edhe në faqen e shkollës në Facebook në përputhje me orarin e përpiluar për përmbajtje zhvillimore-edukative për nxënësit nga shkolla përkatëse, në mënyrë që burimet të jenë në dispozicion të publikut të gjerë.

Dita e punës së nxënësit për mësimin në distancë do të zgjasë nga 3 deri në 5 orë në ditë, varësisht të moshës dhe llojit të aftësisë së kufizuar të nxënësve dhe një pushim prej dhjetë minutash pas çdo ore mësimore apo aktiviteti, sipas orarit të përgatitur në shkollë bazuar në programin mësimor. Mësimi do të zgjasë deri në 30 minuta në varësi të nivelit të shkrim-leximit të informacionit, motivimit, durimit, aftësisë së menaxhimit të kohës, pavarësisë së të mësuarit, aftësisë për të ruajtur vëmendjen dhe përqendrimin dhe specifikave të tjera të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Për nxënësit që nuk kanë kushte teknike dhe qasje në internet në familjet e tyre, shkolla do t'u sigurojë prindërve përmbajtjen mësimore në formë të shtypur/letër.

Komunikimi ndërmjet mësimdhënësve / stafit të shkollës me prindërit është përmes formës elektronike (telefoni, rrjetet sociale, platformat arsimore, ueb faqja zyrtare e shkollës, etj.), përveç nëse është i nevojshëm një takim (p.sh. leksion, ligjëratë edukative).

Shkollat fillore të veçanta në përputhje me ndryshimet ligjore në pjesën e arsimit fillor dhe Konceptin e miratuar për arsimin inkluziv, nga viti shkollor 2020/2021 duhet të funksionojnë si shkollë fillore me një qendër burimesh dhe të ofrojnë mbështetje për shkollat e rregullta. Për atë qëllim, përmes uebfaqes së shkollës, shkollat fillore duhet të mundësohen të shkarkojnë materiale edukative për të mbështetur nxënësit dhe kuadrin mësimor për aktivitete të përbashkëta, plane, programe, etj. E nevojshme është të sigurohen leksione edukative për prindërit/tutorët për mësimin në distancë, përdorimin e mjeteve



dhe platformave arsimore që do të lehtësonin përvetësimin e përmbajtjes së re mësimore gjatë mësimit elektronik ose e-mësimit.

2 Realizimi i mësimit në shkollat e mesme të veçanta

Arsimi i mesëm profesional për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i organizuar në katër shkolla të mesme të veçanta/speciale. (E domosdoshme në organizimin dhe trajnimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore është orientimi i duhur profesional dhe përzgjedhja e profileve dhe profesioneve për të cilat ato mund të përcaktohen, me një vizion dhe mundësi të qartë për punësimin e tyre dhe përfshirjen e përgjithshme në mjedisin shoqëror.

Strukturën e programit e përbëjnë lëndët nga arsimi i përgjithshëm, arsimi profesional dhe trajnimi praktik, ose mësimi praktik, aktivitetet e detyrueshme dhe orët e lira të shkollës, me përqindje të ndryshme të përfaqësimit në varësi të profesionit ose drejtimit që ata mësojnë, nivelit të arsimit, vitit mësimor, si dhe llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar.

Kushtet hapësinore, pajisjet dhe personeli kadrovik i këtyre shkollave mundësojnë realizimin e një modeli të kombinuar të mësimdhënies me prani fizike (nxënësit do të shkojnë në shkollë dhe do të ndjekin mësimet në klasë, punëtori shkollor ose oborrin e shkollës) dhe mësimdhënie online (mësim në distancë ,mësimi përmes internetit e-mësimi) për nxënësit me gjendje kronike ose sëmundje tjera shoqëruese, si dhe për nxënësit të tjerë me nevoja të veçanta arsimore për të cilët prindërit do të deklarohen për këtë lloj mësimi.

Mësimi me prani fizike në shkollë do të organizohen dhe realizohen deri në pesë ditë pune në javë, dhe për secilin nxënës do të përgatitet një plan arsimor individual (PAI) ose një program i modifikuar dhe një orar i veçantë i orëve në pajtim me planin mësimor dhe programeve mësimore të përshtatura për lëndët mësimore për profesionet përkatëse dhe drejtimet në aftësimin profesional dhe atë të punës.

Gjatë vizitës në shkollë, nxënësit, asistentët personal/arsimor, si dhe prindërit/tutorët shoqërues, janë të detyruar të ndjekin të gjitha masat dhe rregullat për mbrojtjen dhe parandalimin nga Covid - 19.

Prindërit/tutorët e fëmijëve me sëmundje të frymëmarrjes, kronike dhe/ose me sëmundje të rralla, si dhe nxënës të tjerë me nevoja të veçanta arsimore që vendosin të ndjekin orët me mësim në distancë nga shtëpia, mësimdhënësit do të përgatisin përmbajtje mësimore, materiale mësimore, prezantime, publikuar në ueb faqen e shkollës si dhe përdorimin e mjeteve arsimore të propozuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja e zhvillimit të arsimit.

Për nxënësit që do të ndjekin mësimet nga shtëpia dhe kanë nevojë për mbështetje profesionale, mësimdhënësi përgjegjës do të sigurojë shërbime konsultative dhe këshillimi për prindërit, prezantime të ushtrimeve dhe aktiviteteve dhe udhëzime për menaxhimin e nevojave individuale në shtëpi.



Kjo mbështetje do të realizohet përmes platformës/platformave që do të miratohen në nivelin e shkollës.

Mësimi në distancë do të realizohet me një kombinim të disa platformave arsimore dhe aplikacioneve dixhitale, Platformës nacionale, portalit Eduino, Google classroom, duke krijuar një platformë Google Drive dhe duke përdorur mjete të tjera alternative të komunikimit elektronik (viber, messenger, zoom) si dhe duke përdorur përmbajtje tjera alternative për komunikimin elektronik. Duke përshtatur programet mësimore janë përcaktuar tema/fusha/komponentë dhe njësi mësimore të caktuara që duhet të realizohen gjatë vitit shkollor, me një kohëzgjatje prej 35 minuta, duke respektuar fondin e parashikuar javor të orëve të përcaktuara në programin mësimor.

Gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programet mësimore të përshtatura, mësimdhënësi duhet të udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, të përcaktuara në programin mësimor. Mësimdhënësi në procesin e përgatitjes së një Plani individual arsimor (PAI) ose një programi të modifikuar për secilin nxënës, planifikon mësimin për 159, përkatësisht 145 ditë mësimore.

Rekomandime për realizimin e programeve mësimore të përshtatura

Mësimdhënësi duhet të planifikojë, organizojë dhe realizojë orë për zhvillimin e përmbajtjes së re mësimore, si dhe orë për përsëritjen, përcaktimin, ushtrimet, kontrollimin e njohurive të nxënësve, etj., varësisht nga lënda mësimore dhe nevojave për realizim të suksesshëm të programit mësimor, përfshirë procesin e mësimnxënies.

Përmbajtja e caktuar mësimore mund të rihvillohet gjatë dy ose më shumë orëve mësimore, e cila sipas llojit dhe shkallës së aftësisë së kufizuar, si dhe specifikës së mësimdhënies dhe mësimnxënies në lëndën mësimore dhe perceptimeve të mësimdhënësit, kërkon më shumë kohë për t'u realizuar. Është e nevojshme të zbatohen metoda dhe strategji të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies të përshtatshme për lëndën, llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar, si dhe aplikimin e mjeteve mësimore specifike dhe materialit tjetër didaktik (teknologji ndihmëse), me qëllim të realizimit të suksesshëm të programit mësimor.

Organizimi dhe realizimi i orës mësimore

Njësitë mësimore për lëndët në arsimin e mesëm profesional për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore realizohen në përputhje me planin mësimor, programet mësimore dhe planin individual arsimor të orëve me kohëzgjatje të shkurtuar prej 35 minuta në varësi të mundësive të nxënësit për



ruajtjen e vëmendjes dhe përqendrimit. Gjatë realizimit të një orë mësimore në të cilën zhvillohet përmbajtje e re mësimore, mësimi duhet të përbëhet nga një pjesë hyrëse, një pjesë kryesore dhe një pjesë përfundimtare. Përveç orëve për zhvillimin e përmbajtjes së re mësimore, sipas programit mësimor, mësimdhënësi duhet të planifikojë, organizojë dhe zbatojë orë për përsëritje, përcaktim, ushtrime, kontroll të njohurive të nxënësve, sistematizim dhe të ngjashme. Këto mësimë duhet të jenë të planifikuara dhe të menduara mirë në mësimin në distancë.

Në orët e ushtrimeve duhet të zgjidhen shembuj të ngjashëm me ato të zhvilluara në orët e reja të përvetësimit të njohurive, por gjithashtu të zgjerohen në shembuj në të cilët nxënësit do të zbatojnë njohuritë e fituara në situata të reja.

Gjatë realizimit të orëve për përsëritje, përcaktim, sistemim dhe testim të njohurive të nxënësve, duhet të përdoren strategji të ndryshme të përshtatshme për lëndën mësimore. Në këtë lloj të orëve, njohuritë e fituara duhet të forcohen, zbatohen dhe rregullohen, ndërliken dhe sistemohen. Kjo mund të realizohet përmes pyetjeve dhe përgjigjeve gojore, diskutimeve, debateve, si dhe përmes zgjidhjes së problemeve, situatave të problemeve, kuize, testeve, duke aplikuar mjete të përshtatshme TI.

Parashtrimi dhe përdorimi i përmbajtjeve elektronike (e-përmbajtjeve) për arsimin fillor dhe të mesëm

Pavarësisht nëse bëhet fjalë për mësimdhënie në arsimin fillor apo të mesëm, përmbajtjet elektronike (të tilla si: prezantime teksti, prezantime audio/video dhe përmbajtje të tjera më të thjeshta elektronike) përgatiten dhe vendosen nga mësimdhënësi në platformë dhe ato mund të jenë në dispozicion edhe nga shkolla gjatë realizimit të mësimin të rregullt, si dhe për realizimin e mësimdhënies dhe mësimin në distancë.

Gjithashtu, në platformë do të vendosen përmbajtjet elektronike (e-përmbajtjet) më komplekse të furnizuara dhe të lejuara nga Byroja e zhvillimit të arsimit, Qendra për arsim profesional dhe trajnime dhe Qendra shtetërore e provimeve, të cilat janë në përputhje me programet mësimore, do të vendosen në platformë, në mënyrë që të jenë mbështetje plotësuese për nxënësit në mësimin e një njësie të caktuar mësimore (mësimë video të inçizuara nga mësimdhënësit shoqëruar me një prezantim) ose për të zgjeruar dhe thelluar njohuritë e nxënësve, për të përmirësuar të arriturat e nxënësve, për të kontrolluar njohuritë dhe të arriturat e nxënësve. Përmbajtjet elektronike (e-përmbajtjet) do të jenë në dispozicion të mësimdhënësve dhe nxënësve në shkollë, si dhe gjatë organizimit dhe realizimit të procesit mësimor dhe mësimin në distancë.

